



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe Programi i Drejtësisë Komerçiale i USAID

# ■ Studimi mbi Perceptimin e Korrupsionit 2021





## Studimi mbi Perceptimin e Korrupsionit 2021

Publikuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë në partneritet me Programin e Drejtësisë Komerciale të USAID

**Autorë:**

Arian ZEKA

Andina VLLAHIU KELMENDI

Dhjetor 2021

**DEKLARATË PËR HEQJE TË PËRGJEGJËSISË:**

Përmbajtja e këtij studimi nuk përfaqëson doemos pikëpamjet e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë apo të Programit të USAID për Drejtësi Komerciale.

Ky studim mund të riprodhohet, shumëzohet apo të transmetohet në formë elektronike, mekanike, të fotokopjuar, të regjistruar apo në ndonjë mënyre tjetër, me kusht që atributi ndaj Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe Programit të USAID për Drejtësi Komerciale të shfaqet i qartë në çdo kopje të bërë dhe të shpërndarë.



## Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive .....	5
Hyrje.....	7
1. Metodologjia .....	7
2. Studimi i Perceptimit të Korrupsionit 2021 .....	9
3. Korrupsioni brenda sektorit privat .....	23
4. Raportimi i korrupsionit.....	24
5. Përmirësimi i qeverisjes korporative për të luftuar korrupsionin .....	28
6. Konkluzionet .....	30



## Përmbledhje ekzekutive

Studimi i Perceptimit të Korrupsionit i kryer nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, gjatë katër viteve të fundit, ka treguar se shkalla e korrupsionit është në rritje vit pas viti, duke e pamundësuar kështu punën e bizneseve të sektorëve të ndryshëm dhe duke ndikuar në zhvillimin e gjithmbarshëm shoqëror dhe ekonomik të Kosovës. Megjithatë, studimi i këtij viti tregon një rritje të optimizmit të bizneseve lidhur me angazhimin e Qeverisë së re e cila është në pushtet që nga marsi i vitit 2021 me qëllim për të luftuar korrupsionin.

Sipas pyetësorit të kryer me 121 ndërmarrje, në të gjitha rajonet dhe komunat e Kosovës, emigrimi i fuqisë punëtore renditet si problemi i parë me të cilin përballen bizneset në Kosovë dhe kjo sipas 55.37% të respondentëve, derisa korrupsioni këtë vit raportohet si problemi i dytë i ballafaquar nga ana e bizneseve dhe atë sipas 43.80% të respondentëve. Pandemia COVID19 renditet shumë më poshtë këtë vit, krahasuar me vitin paraprak, për çka lehtësimi i masave mund të ketë pasur ndikim në këtë renditje.

Këtë vit, rreth 12% e respondentëve besojnë se krahasuar me pesë vitet e fundit, korrupsioni në Kosovë është rritur, gjë që, krahasuar me studimin e vitit të kaluar ka shënuar një rënie të madhe.

Ryshfeti mbetet lloji më i zakonshëm i korrupsionit në Kosovë, i përcjellë nga keqpërdorimi i parasë publike, nepotizmi dhe klientelizmi dhe specifikimi i prokurimit publik për të favorizuar ofertues/aplikues individualë.

Sundimi i dobët i ligjit raportohet të jetë ende faktori numër një që kontribuon në korrupsion, sipas më shumë se 83% e respondentëve, duke shënuar kështu një rritje të ulët krahasuar me studimin e vitit 2020, pastaj mungesa e vullnetit politik për të luftuar korrupsionin me 61% e përgjigjeve, që krahasuar me studimin e vitit të kaluar ka treguar një rënie mjaft të madhe.

Afro 30% e respondentëve kanë dhënë përgjigje negative për besimin në sistemin e drejtësisë, duke shënuar një rënie në krahasim me studimin e vitit 2020, ndërkohë që rreth 11 për qind e tyre e kanë vlerësuar si të pjesshëm besimin e tyre në këtë sistem, i cili krahasuar me pyetësorin e vitit 2020 ka shënuar rënie.

Për më tepër, 18% e respondentëve kanë pohuar se nuk se sistemet e drejtësisë, siç janë policia, prokuroria dhe gjykatat në Kosovë, janë efektive në luftën kundër korrupsionit. Kjo ka shënuar një rënie të madhe në krahasim me studimin e vitit të kaluar, me 50% e respondentëve që nuk besojnë që këto mekanizma janë zbatues.

Mbi 88% e bizneseve kanë treguar se nuk kanë raportuar asnjëherë rastet e korrupsionit tek autoritetet, e cila është rritur nga viti i kaluar, mirëpo vazhdon të jetë shqetësuese. Është e pashmangshme që niveli i lartë i korrupsionit pengon rritjen e investimeve të huaja direkte, me gati 90% të respondentëve që ndajnë të njëjtin mendim.

Pyetësori i vitit 2021 ka vlerësuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit është institucioni më i korrumpuar dhe kjo sipas pikëpamjes së 57% e respondentëve, e përcjellë nga gjykatat sipas vlerësimit të afro 50% e respondentëve dhe ndërmarrjet në pronësi publike me 49%, komunat me 47%, doganat me 43%, duke e lënë Qeverinë si të gjashtin me radhë, me

41%. Është tejet interesante të shihen këto ndryshime, pasi viti 2021 shënon vitin e parë që bizneset nuk kanë zgjedhur Qeverinë si institucionin më të korruptuar.

Kur bëhet fjalë për korrupsionin e perceptuar nga funksionet e biznesit, 41% e respondentëve besojnë se korrupsioni është më i pranishëm në auditim dhe kontabilitet, i përcjellë me 39% e respondentëve që besojnë se korrupsioni ndodh në sektorin e shitjes dhe afro 38% e respondentëve që besojnë se korrupsioni është i pranishëm edhe në shërbimet ligjore. Kjo e fundit është veçanërisht shqetësuese, duke pasur parasysh rëndësinë e profesionistëve të kontabilitetit, të cilët kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në luftën kundër ekonomisë joformale.

Ngjashëm me vitet e mëparshme, përqindja e respondentëve që kanë raportuar korrupsion mbetet shumë e ulët. Këtë vit, vetëm 11.57% e respondentëve kanë raportuar korrupsion, i cili ka shënuar rënie krahasuar me studimin e vitit të kaluar. Më në fund, pyetësi i këtij viti zbulon se përqindja e atyre që kanë raportuar korrupsionin në Agjencinë Kundër Korrupsionit është rritur nga 22% në 50%, krahasuar me vitin 2020.

## Hyrje

Studimi i Perceptimit të Korrupsionit 2021 është publikimi i katërt vjetor i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, i cili në tre vitet e fundit mbështetet nga Programi i USAID për Drejtësi Komerciale.

Anketa e vitit 2021 u realizua me 239 biznese, megjithatë për qëllime të gjenerimit të gjetjeve të besueshme mbi perceptimin e korrupsionit në Kosovë, Oda Amerikane dhe Programi i USAID për Drejtësi Komerciale kanë analizuar vetëm pyetësorët e përfunduara plotësisht, pra, të 121 bizneseve të të gjitha madhësive dhe sektorëve përreth Kosovës, përmes platformës së anketimit të bazuar në internet.

Studimi i vitit 2021 përqendrohet për herë të dytë me radhë në perceptimin dhe korrupsionin e hasur brenda sektorit privat, pra, në transaksionet biznes me biznes, ndërsa për herë të parë përqendrohet edhe në perceptimin dhe korrupsionin e hasur në organizatat ndërkombëtare. Si fund, studimi i këtij viti përqendrohet në 'pulsin' e bizneseve mbi angazhimin e Qeverisë së re për të luftuar korrupsionin.

## 1. Metodologjia

Studimi i Perceptimit të Korrupsionit këtë vit u krye në platformë interneti, me 121 pyetësor plotësisht të përfunduara nga biznese të të gjitha madhësive, në shtatë rajonet e Kosovës: Prishtinë (66%), Ferizaj (4.13%), Gjilan, Mitrovicë dhe Prizren (3.31% secila), Pejë dhe Gjakovë (1.65% secila) dhe komunat e tjera anembanë Kosovës (16.53%).

Pothuajse dy të tretat e respondentëve punësojnë 1-10 persona, dhe kjo në përputhje me strukturën e bizneseve anembanë Kosovës, ku bizneset e vogla dominojnë këtë strukturë. Kjo përcjellët me 16.5% e respondentëve që punësojnë 51-250 persona dhe 14.05% e bizneseve që janë përgjigjur se punësojnë 11-50 persona dhe, së fundi, 6.61% e respondentëve që punësojnë mbi 250 persona.






Fig. 1.1. Respondentët sipas numrit të të punësuarve



**Fig. 1.2. Respondentët sipas vendndodhjes**

Dy të tretat e respondentëve operojnë në sektorë të shërbimeve të këshillimit të biznesit (14.88%), tregti (14.05%), shërbime financiare (13.22%), prodhim (12.40%), teknologji e informacionit dhe komunikim (10.74%), ndërtimtari dhe patundshmëri (7.44%), ndërkohë që respondentët e tjerë kanë veprimtari të larmishme biznesi (27.27%).




**Fig. 1.3. Respondentët sipas sektorëve**





## 2. Studimi i Perceptimit të Korrupsionit 2021

Korrupsioni prek ndërmarrjet e sektorit privat në forma dhe mënyra të ndryshme. Kjo është pengesë tejet kritike ndaj konkurrencës, sepse kompanitë të cilat nuk përfshihen në korrupsion përjashtohen nga mundësitë e barabarta të tregut. Kjo, përfundimisht, ka ndikim në të gjithë zinxhirin e rritjes dhe zhvillimit. Korrupsioni minimizon paranë publike dhe cilësinë e shërbimeve publike dhe mallrave.



**Fig. 2.1. Çështjet kryesore me të cilat ballafaqohen sot bizneset**


Korrupsioni renditet si çështja e dytë me të cilën ballafaqohen bizneset në Kosovë dhe ky perceptim sipas afro 44% e respondentëve, me një rënie të madhe nga viti i mëparshëm. Në krye të listës është emigrimi i fuqisë punëtore, siç janë përgjigjur mbi 55% e respondentëve. Kjo është edhe në përputhje me shqetësimin e bizneseve që u nda më së shumti në muajt e fundit. Vetëm një vit më parë, kjo çështje u raportua si problemi i pestë më shqetësues për bizneset në vend, me pandeminë COVID-19 që përfundoi si 'kampion' në këtë kategori në vitin 2020.

Kapitali njerëzor dhe çështjet lidhur me të duket të jenë midis tre çështjeve kryesore me të cilat ballafaqohen bizneset në Kosovë, me sistemin arsimor të pazhvilluar që përcjellët me rreth 40% e respondentëve. COVID-19 duket se e ka humbur 'rëndësinë' e saj si problematikë, pasi këtë vit renditet në vendin e gjashtë dhe mbetet problem vetëm për 37% e respondentëve. Vendi i katërt është rezervuar edhe këtë vit, në mënyrë të ngjashme me vitin e kaluar, për sistemin gjyqësor joefikas.


Ka një rënie të ndjeshme në përqindje të bizneseve që besojnë se korrupsioni është një çështje shumë kritike në Kosovë, ku këtë vit besohet nga më pak se 50% e respondentëve, krahasuar me rreth 78% e respondentëve nga viti i kaluar. Duhet theksuar se baza e respondentëve ishte pothuajse e njëjtë midis dy viteve.

Në vitin 2021 bizneset kanë raportuar se çështja e korrupsionit është ende kritike, por më pak alarmuese. Përqindja e respondentëve që besojnë se korrupsioni është çështje kritike, por jo në një shkallë alarmuese ka shënuar rritje krahasuar me vitin e mëparshëm, me rreth 39% e respondentëve kundrejt 13% të tyre në 2020. Shohim, gjithashtu, një rritje të bizneseve që këtë vit besojnë se korrupsioni nuk është çështje kritike në Kosovë me 4%,

krahasuar me më pak se 2% në vitin paraprak. Një tjetër rezultat pozitiv, është se këtë vit asnjë nga respondentët nuk mohojnë ekzistencën e korrupsionit në Kosovë, siç paraqitet në grafikun 2.2. më poshtë.



**Fig. 2.2. Cila nga të mësipërmet pasqyron më së miri gjendjen aktuale të korrupsionit në Kosovë?**




**Fig. 2.3. Cili nga qëndrimet e mësipërme pasqyron më së miri gjendjen aktuale të korrupsionit në Kosovë?**

Grafiku 2.3. më sipër tregon se kur flitet për besimin e bizneseve mbi gjendjen e korrupsionit në Kosovë, 45.45% e respondentëve besojnë se Kosova ka një korrupsion sporadik, përcjellë nga 43.80% e atyre që besojnë se korrupsioni është sistematik dhe 4.13% e atyre që besojnë se niveli i korrupsionit në Kosovë është i ulët, i cili është i barabartë me përqindjen e atyre që besojnë se korrupsioni nuk është çështje kritike në Kosovë.

Rreth 58% e respondentëve besojnë se Qeveria aktuale, e cila është në fuqi që nga marsi i vitit 2021, është e angazhuar për të luftuar korrupsionin. Nga kjo përqindje, 47% besojnë




se rezultatet ende mungojnë, ndërsa 11% besojnë se rezultatet janë të dukshme. Rreth 15% e respondentëve presin demonstrim në përkushtim në të ardhmen e afërt, ndërsa afro 20% e tyre janë më pesimistë duke shprehur skepticizmin e tyre lidhur me ndryshimet në angazhimin e Qeverisë në luftën kundër korrupsionit. Gjetjet e detajuara janë paraqitur në grafikun 2.4. më poshtë.



**Fig. 2.4. A besoni se Qeveria aktuale është e angazhuar për të luftuar korrupsionin?**


Të pyetur për krahasimin e ndryshimeve në nivelin e korrupsionit, 57% e respondentëve kanë raportuar se korrupsioni nuk duket të ketë shënuar ndonjë ndryshim në 5 vitet e fundit. Gati një e katërta e respondentëve besojnë se kjo ka pësuar rënie, ndërkohë që rreth 11% e tyre besojnë se, realisht, ka shënuar rritje krahasuar me pesë vitet më parë. Krahasuar me vitin e kaluar, duket të ketë perceptim pozitiv në lidhje me ndryshimet në nivelin e korrupsionit në një periudhë pesë-vjeçare. Në vitin 2020, mbi 41% e respondentëve ishin shprehur se korrupsioni është rritur, në fakt, në pesë vitet e fundit, ndërsa rreth 35% besojnë se ka mbetur i njëjtë, dhe vetëm afro 11% e tyre që besojnë se shënoi rënie në pesë vitet e fundit.

Këtë vit, në përgjithësi, është vënë re një ton më pozitiv lidhur me perceptimin e korrupsionit dhe përpjekjeve që po ndërmerren për ta luftuar atë, duke përfshirë angazhimin e qeverisë për të luftuar këtë dukuri. Shpresojmë se do të merren masa konkrete nga Qeveria dhe organet përkatëse për të luftuar këtë dhe për të shmangur çdo zhgënjim të mundshëm brenda sektorit privat.




**Fig. 2.5. Ndryshimet në nivelin e korrupsionit krahasuar me 5 vite më parë?**

Nuk duket të ketë ndonjë lidhje midis lidhje midis pandemisë COVID-19 dhe përkeqësimit në nivelet e korrupsionit në Kosovë, me 42% e bizneseve që besojnë se pandemia nuk ka pasur ndikim të rëndësishëm në nivelet e korrupsionit dhe 28% e tyre besojnë se ka ndodhur kjo, siç shihet në grafikun më poshtë. Kjo shënon përmirësim nga viti i kaluar, ku afro 40% kishin raportuar se COVID-19 ka pasur një efekt në rritjen e korrupsionit, siç tregohet në grafikun 2.6. më poshtë.



**Fig. 2.6. A ka ndikuar COVID-19 në nivelet e korrupsionit në Kosovë?**






**Fig. 2.7. Format e perceptuara të korrupsionit në Kosovë**

Kur bëhet fjalë për format e perceptuara të korrupsionit, ryshfeti renditet i pari me pothuajse 62% e respondentëve që vlerësojnë atë si formën më të pranishme të korrupsionit. Kjo mund të jetë edhe për shkak të faktit se shumica e njerëzve lidhin korrupsionin me ryshfetin. Ryshfeti përcillet nga keqpërdorimi i parasë publike, sipas pikëpamjeve të rreth 58% e respondentëve, dhe nepotizmi dhe klientelizmi sipas pikëpamjeve të 52% e respondentëve. Këto kanë qenë tre format kryesore të korrupsionit të raportuara gjatë 3 viteve të fundit.


Gjetjet e këtij viti në treguesin e përmendur janë absolutisht të krahasueshme, për sa i përket gjetjeve të vitit të kaluar, si dhe ato të vitit 2019. Dhe, kjo zbatohet edhe në forma të tjera korrupsioni.

Të njëjtat gjetje aplikohen edhe për arsytet që motivojnë bizneset të përfshihen në korrupsion krahasuar me vitin e kaluar. Rreth 72% e respondentëve përmendin marrjen e një trajtimi të favorshëm në një procedurë të hapur/konkurrese krahasuar me rreth 71% e respondentëve në vitin 2020. Përshpejtimi i procedurës burokratike është arsyeja e dytë e renditur me rreth 68% të respondentëve këtë vit, dhe ishte arsyeja e dytë e renditur gjithashtu në 2020. Ngjashëm nga viti i kaluar, shmangia e dënimit përmendet si arsyeja e tretë që i motivon bizneset të përfshihen në korrupsion. Dhe së fundi, këtë vit dhe vitin e kaluar, qasja në shërbime të posaçme përmendet si faktori i katërt që i shtyn bizneset drejt korrupsionit, siç mund të shihet në grafikun 2.8. më poshtë.



**Fig. 2.8. Çfarë i shtyn bizneset të përfshihen në korrupsion?**


Mbi 83% e bizneseve zgjedhën sundimin e dobët të ligjit si faktorin kryesor që kontribuon në korrupsion, përcjellë nga 61% e respondentëve që përmendin mungesën e vullnetit politik për të luftuar korrupsionin. Dhe përsëri, ngjashëm me vitin 2020, rrogat e ulëta dhe varfëria besohet të jenë faktori i tretë që kontribuon në korrupsionin në vend. Ka një ndryshim vendesh midis pasigurisë politike dhe kuadrit ligjor jo të plotë këtë vit, krahasuar me vitin e mëparshëm.




**Fig. 2.9. Faktorët që kontribuojnë në praninë e korrupsionit sipas bizneseve**

Kur bëhet fjalë për korrupsionin si pengesë e Investimeve të Huaja Direkte (IHD), rreth 87% e respondentëve e ndajnë këtë mendim, ndërkohë që më pak se 10% e respondentëve besojnë se ka ndikim mbi IHD, por nuk është faktor i dëmshëm. Duhet vënë në dukje se asnjë nga respondentët nuk besojnë se korrupsioni nuk ka ndonjë ndikim mbi IHD. Pothuajse një perceptim i ngjashëm u krijua nga pyetësi i vitit të kaluar, si dhe në katër vitet e fundit, në përgjithësi.






**Fig. 2.10. A është korrupsioni një pengesë për IHD?**



**Fig. 2.11. A ka ndikuar korrupsioni në vendimet e respondentëve për të investuar në Kosovë në të kaluarën?**


Siç mund të shihet në grafikun e mësipërm, rreth 45% e respondentëve në Kosovë besojnë se korrupsioni ka ndikuar në vendimet e tyre për të investuar në Kosovë, në të kaluarën, krahasuar me 53% e respondentëve që kanë pohuar këtë në studimin e vitit të kaluar, i cili është dukshëm më i vogël krahasuar me 2020. Më e lartë është përqindja e atyre që thonë se korrupsioni nuk ka ndikuar në vendimin e tyre për të investuar në vend, ku këtë e besojnë afro 22% e respondentëve krahasuar me 13% në vitin paraprak.

Ngjashëm me vitet e mëparshme, bizneset bazojnë vlerësimin e tyre në nivelin e korrupsionit në përvojën e miqve/partnerëve të tyre, përcjellë afër nga përvoja e tyre personale, dhe pastaj nga raportet e përgatitura nga organizatat ndërkombëtare, raportet e medieve dhe raportet e organizatave lokale. Është një fakt interesant që organizatat lokale gëzojnë besim më të vogël midis ndërmarrjeve të sektorit privat në Kosovë. Një analizë e hollësishme e këtyre të gjeturave mund të shihen në grafikun më poshtë.



**Fig. 2.12. Informacion se cilat biznese mbështeten në vlerësimin e tyre mbi nivelin e korrupsionit?**

Qeveria e Kosovës ka lëvizur për 6 vende më poshtë këtë vit në renditjen e institucioneve me nivelin më të lartë të korrupsionit, krahasuar me vitin e mëparshëm kur është renditur në vendin e parë. Organi Shqyrtues i Prokurimit është "kurorëzuar" si një kampion në këtë kategori, përcjellë nga gjykatat që mbajtën vendin e dytë vitin e kaluar dhe ndërmarrjet publike që kanë lëvizur për tre vende në drejtim të perceptimit si institucionet më të korruptuara.



**Fig. 2.13. Korrupsioni i perceptuar nga institucionet sipas bizneseve**

Përfshirë për herë të parë në këtë pyetësor, organizatat ndërkombëtare besohet gjithashtu të jenë të korruptuara me afro 15% e respondentëve që pohojnë këtë. Arbitrazhi, si një mekanizëm alternativ i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve është institucioni me renditjen më të ulët lidhur me perceptimin e korrupsionit, me vetëm 2.48% e respondentëve që besojnë se ka korrupsion në këtë mekanizëm.


52% e respondentëve besojnë se institucionet përgjegjëse nuk janë shumë efektive në luftën kundër korrupsionit, dhe pothuajse një e treta e tyre besojnë se institucionet nuk






janë aspak efektive në luftën kundër korrupsionit, dhe 1.65% e respondentëve që besojnë se institucionet janë shumë efektive. Kjo e fundit pothuajse përsëri mund të krahasohet me studimin e vitit 2020, sipas të cilit 2.07% e respondentëve pohuan këtë.

Vetëm 11.5% e respondentëve besojnë se institucionet janë efektive në luftën kundër korrupsionit, që përbën një rritje të vogël krahasuar me vitin e kaluar, ku më pak se 2% e bizneseve besonin se institucionet ishin efikase në luftën kundër korrupsionit.



**Fig. 2.14. Efikasiteti i institucioneve përgjegjëse në luftën kundër korrupsionit**




**Fig. 2.15. A janë ballafaquar bizneset me korrupsion në sektorin publik?**


Ngjashëm me vitet e kaluar, ka një hendek midis përqindjes së bizneseve që janë ballafaquar me korrupsionin kundrejt përqindjes më të lartë të atyre që e shohin korrupsionin si problem në vend. Gjetjet mbeten pothuajse të njëjta krahasuar me vitin 2020. Rreth 39% e bizneseve kanë ndeshur korrupsion krahasuar me 40% në vitin e mëparshëm, i cili duket të jetë pothuajse i njëjtë. Rreth 30% është përqindja e respondentëve që nuk kanë hasur në korrupsion krahasuar me 31% që e deklaruan këtë në 2020.

Duket se ka një ngjashmëri sa i përket renditjes së institucioneve në të cilat bizneset kanë hasur me korrupsion, Organi Shqyrtues i Prokurimit është renditur i pari nga 32% e bizneseve që kanë raportuar se kanë hasur në fakt korrupsion, ndonëse e njëjta përqindje është e ndarë me Administratën Tatimore të Kosovës dhe Gjykatat. Edhe në këtë kategori të korrupsionit aktual, qeveria renditet e pesta me rreth 23%.

Është inkurajuese të shohësh se bizneset nuk janë ballafaquar ndonjëherë me korrupsion në arbitrazh, i cili normalisht është nxitur si një mekanizëm shumë efikas i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Kjo duhet patjetër të nxisë rëndësinë e këtij mekanizmi si një trup i besuar.



**Fig. 2.16. Institucionet në të cilat bizneset janë ballafaquar me korrupsionin**




**Fig. 2.17. A është korrupsioni i pranishëm në veprimtaritë e prokurimit publik sipas bizneseve?**

Perceptimi i pranishëm së korrupsionit në veprimtaritë e prokurimit publik mbetet ende mjaft i lartë me 42.98% që besojnë se korrupsioni është shumë i pranishëm në veprimtaritë e prokurimit publik, megjithatë, krahasuar me vitin e kaluar (52%), shohim rënie. Në përgjithësi, 90% e respondentëve besojnë se korrupsioni është i pranishëm deri




diku në veprimtaritë e prokurimit publik, me pjesën e mbetur të respondentëve që nuk e dinë këtë dhe ngjashëm me vitin e kaluar, zero përqind e respondentëve që pretendojnë se korrupsioni nuk është fare i pranishëm në proceset e tenderimit publik.

Grafiku 2.18. më poshtë tregon ndikimin e prokurimit elektronik, me rreth 46% e respondentëve që besojnë se prokurimi elektronik do të ndihmojë në luftimin e korrupsionit deri në njëfarë mase, me 28.10% e respondentëve që besojnë se e-prokurimi do të ndihmojë shumë në luftën e korrupsionit dhe 14% që pretendojnë se nuk do të ketë ndikim në luftën kundër korrupsionit, e cila është rritur krahasuar me studimin e vitit të kaluar.




**Fig. 2.18. A do të ndihmojë prokurimi elektronik në luftën kundër korrupsionit?**

Grafiku më poshtë tregon transparencën e institucioneve publike në shkallë nga 1-5, ku 5 është niveli më i lartë i transparencës. Mund të vërehet lehtë se organizatat ndërkombëtare dhe Administrata Tatimore e Kosovës janë perceptuar me një përqindje më të lartë për transparencën e tyre, ndërsa Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe ndërmarrjet publike kanë përqindjen më të ulët sa i përket transparencës.




**Fig. 2.19. Renditja e institucioneve publike për sa i përket transparencës nga 1-5, ku 5 paraqet nivelin më të lartë të transparencës**



**Fig. 2.20. A i besojnë bizneset sistemit gjyqësorë në Kosovë?**

Siç paraqitet në grafikun 2.20. më lartë, 60% e respondentëve besojnë pjesërisht në funksionimin e sistemit gjyqësor në Kosovë. Kjo është rritur në krahasim me vitin e kaluar (2020) ku numri i respondentëve që i besonin pjesërisht sistemit gjyqësor ishte 47%. 29% e respondentëve kanë shprehur reagimin e tyre negativ ndaj besimit në gjyqësor, duke e krahasuar atë me vitin e kaluar, ka një përmirësim të ndjeshëm, ku mungesa e besimit në funksionin e sistemit gjyqësor ishte 50%. 11% e respondentëve besojnë se sistemi gjyqësor në Kosovë funksionon siç duhet, gjë që shënon gjithashtu një përmirësim të ndjeshëm nga viti i kaluar, ku respondentët që besonin në funksionimin e sistemit gjyqësor ishin vetëm 3%.




**Fig. 2.21. A do të përmirësojë vetingu i paralajmëruar sistemin gjyqësor në Kosovë?**

Grafiku 2.21. më lartë paraqet përmirësimin në sistemin gjyqësor në Kosovë me vetingun e njoftuar, ku më shumë se 50% e respondentëve besojnë se vetingu do të përmirësojë




sistemin gjyqësor. Një numër prej afro 32% e respondentëve kanë dhënë përgjigjen se nuk e dinë nëse vetingu do të përmirësojë sistemin gjyqësor dhe një përqindje më e ulët se 15 janë përgjigjur negativisht ndaj kësaj.



**Fig. 2.22. Efektiviteti i mekanizmeve të sundimit të ligjit në luftën kundër korrupsionit (policisë, prokurorisë dhe gjykatave)?**

Në grafikun 2.22. më lartë, rreth 63% e respondentëve kanë pohuar se nuk besojnë se mekanizmat zbatues (policia, prokuroria, gjykatat) janë efektive në luftën kundër korrupsionit, ku 17% e kanë renditur atë si aspak efektiv, së bashku me 46% që deklaruan se nuk ishte shumë efektiv, ndërsa rreth një e treta i kanë vlerësuar mekanizmat e zbatimit si të efektshëm, me 22% si efektive, dhe 11% si shumë efektive.

Përveç kësaj, kur krahasojmë përgjigjet me studimin e vitit të kaluar, kemi gjetur një përmirësim të madh në perceptim. Në vitin 2020, rreth 88% e respondentëve kishin deklaruar se gjejnë mekanizma zbatimi (38%) ose jo efektivë (50%), dhe vetëm rreth 10% e tyre kishin vlerësuar mekanizmat e zbatimit si efektivë (8%) ose shumë efektivë (2%).




**Fig. 2.23. A ka Kosova kuadër të mirë ligjor për të luftuar korrupsionin?**

45% e respondentëve besojnë se kuadri ligjor i Kosovës është pjesërisht i mirë në luftën kundër korrupsionit, i cili është pak më i lartë krahasuar me studimin e vitit të kaluar (41%).

Një numër i ulët prej 25.6% besojnë se kuadri ligjor i Kosovës është mjaft i mirë për të luftuar korrupsionin, i cili nuk ka ndryshuar shumë krahasuar me vitin e kaluar, i cili gjeti se 24% e bizneseve besojnë se kuadri ligjor është i mirë.


### 3. Korrupsioni brenda sektorit privat

Ky studim ka zbuluar se rreth dy të tretat e respondentëve besojnë se ka korrupsion në transaksionet/marrëdhëniet biznes-biznes në sektorin privat dhe një e treta e bizneseve nuk besojnë se korrupsioni ekziston në sektorin privat.




**Fig. 3.1. Perceptimi i korrupsionit në transaksionet/marrëdhëniet biznes-biznes**

Kur flasim për perceptimin e korrupsionit nga lloji i operimit, 41.32% besojnë se korrupsioni është më i pranishëm në sektorin e auditimit dhe kontabilitetit, gjë që është interesante pasi kjo përqindje nuk ka ndryshuar krahasuar me vitin e kaluar. Një dallim i ndjeshëm pozitiv në krahasim me vitin e kaluar shihet lidhur me shërbimet ligjore, duke rënë nga rreth 50% në vitin e kaluar në 38% këtë vit.




**Fig. 3.2. Korrupsioni i perceptuar në sektorin privat nga lloji i operimit**

Se a kanë hasur në ndonjë formë të korrupsionit, vetëm afro 25% e respondentëve kanë hasur në korrupsion, me të njëjtën përqindje të respondentëve që preferojnë mos ti përgjigjen kësaj pyetjeje, ndërkohë që përqindja më e lartë e respondentëve, 50.41% deklaruan se nuk kanë hasur në korrupsion në sektorin privat. Ekziston një hendek i madh midis perceptimit të korrupsionit dhe ballafaqimit me korrupsion, ngjashëm me perceptimin e korrupsionit në sektorin publik, siç shihet në grafikun më poshtë 3.3.

**Fig. 3.3. Korrupsioni i hasur në sektorin privat**


#### 4. Raportimi i korrupsionit

Ngjashëm me vitet e mëparshme, më pak se 90% e bizneseve janë përpjekur të raportojnë korrupsionin, me vetëm 11.5% të respondentëve që pretendojnë se kanë raportuar korrupsion në institucionet përkatëse. Kjo vazhdon të jetë shqetësuese, duke ditur se bizneset dhe qytetarët janë një hallkë e rëndësishme në zinxhirin e luftës kundër korrupsionit. Megjithatë, mekanizmat e rendit të ligjit duhet të demonstrojnë rezultate të qarta në luftën kundër korrupsionit, me qëllim që bizneset të rritin besimin e tyre në këto mekanizma. Kjo mund të rezultojë edhe në rritjen e raportimit në vitet në vijim.






**Fig. 4.1. A kanë raportuar bizneset korrupsionin tek autoritetet përkatëse?**




**Fig. 4.2. Ku kanë raportuar bizneset korrupsionin?**

Studimi i këtij viti gjen se përqindja e bizneseve që kanë raportuar korrupsionin në Agjencinë Kundër Korrupsionit është rritur në mënyrë drastike, krahasuar me vitin e kaluar. Këtë vit, 50% e respondentëve kanë raportuar në Agjencinë Kundër Korrupsionit, ndërsa vitin e kaluar vetëm 22%. Është tepër inkurajuese të shohësh një raportim në rritje të kësaj agjencie, duke ditur autoritetin e saj për të nisur dhe kryer procedurat për zbulimin paraprak apo hetimin kundër korrupsionit. Mund të supozohet, se si rezultat i Qeverisë së re, e cila i është përkushtuar, në mënyrë deklarative, luftës kundër korrupsionit, njerëzit kanë fituar më shumë besim në institucione dhe raportimin e korrupsionit në Agjencinë Kundër Korrupsionit, e edhe në institucionet tjera.

Ka një dallim që duhet theksuar midis atyre që pretendojnë se kanë raportuar korrupsionin dhe atyre, të cilët, në fakt, kanë raportuar atë. Dallimi është mjaft i vogël, krahasuar me studimin e vitit 2020, në të cilin 50% e respondentëve kanë pretenduar të raportojnë të gjitha rastet e korrupsionit, ndërsa këtë vit, kemi parë një rritje të kësaj, me 65% të respondentëve që pretendojnë se do të raportojnë të gjitha rastet e korrupsionit në të ardhmen. Duhet theksuar se përqindja e atyre që angazhohen për të raportuar korrupsionin, vetëm nëse ka ndikim të rëndësishëm për kompaninë e tyre, është ulur krahasuar me vitin e kaluar nga 32.98% në 24.79%. Për më tepër, përqindja e respondentëve që përfundimisht nuk do të raportojnë korrupsionin ka pësuar rënie, krahasuar me vitin e kaluar, nga 4.52% në 1.65%.




**Fig. 4.3. A do të raportojnë bizneset korrupsionin në të ardhmen?**



**Fig. 4.4. A kanë njohuri bizneset se korrupsioni mund të raportohet në mënyrë anonime në Agjencinë Kundër Korrupsionit?**

Lidhur me raportimin e korrupsionit në Agjencinë Kundër Korrupsionit, duhet theksuar se rreth 65% e respondentëve janë të vetëdijshëm se mund të raportojnë korrupsionin në mënyrë anonime në këtë Agjenci, e cila ka shënuar rritje krahasuar me studimin e vitit të kaluar, ku 58% e respondentëve kanë njohuri për këtë. Rrjedhimisht, numri i respondentëve që nuk kanë njohuri se mund të raportojnë në këtë Agjenci (36%) është ulur këtë vit, krahasuar me vitin e kaluar me 42%.






**Fig. 4.5. Pse bizneset ngurrojnë të raportojnë korrupsionin?**

Siç paraqitet në grafikun 4.5. më lartë, frika e hakmarrjes ndaj biznesit nga ai institucion në të ardhmen, mbetet faktori kyç prapa hezitimit të bizneseve për të raportuar korrupsionin, me 85.12% e respondentëve që pretendojnë këtë, pasuar nga mungesa e besimit në institucionet gjyqësore me 76.86% e respondentëve. Mbi 55% e respondentëve pohojnë pakënaqësi me rezultatet e luftës kundër korrupsionit deri më tani. Studimi i këtij viti gjen një rritje ndaj atyre që ngurrojnë të raportojnë korrupsionin, për shkak të rezultateve të pakënaqshme në luftën kundër korrupsionit, nga 53% në 57%.

## 5. Përmirësimi i qeverisjes korporative për të luftuar korrupsionin




**Fig. 5.1. A kanë bizneset informacion mbi parimet e qeverisjes korporative?**

Bizneset raportojnë një nivel të kënaqshëm njohurish mbi parimet e qeverisjes korporative, pasi Studimi i këtij viti gjen se afërsisht 87% e respondentëve kanë njohuri rreth këtyre parimeve, dhe vetëm 13% e tyre që nuk kanë njohuri mbi parimet e qeverisjes korporative. Siç tregohet në grafikun e mësipërm, rreth 44% e respondentëve kanë njohuri mbi parimet e qeverisjes korporative dhe kanë filluar t'i zbatojnë ato në kompanitë e tyre, gjë që ka shënuar rritje të madhe krahasuar me Studimin e vitit të kaluar, i cili gjeti 33% të respondentëve që kanë zbatuar këto parime në kompanitë e tyre. Megjithatë, numri i respondentëve që pretendojnë se kanë informacion të pjesshëm rreth këtyre parimeve është ulur nga viti i kaluar, nga 36% në 27%, përcjellë nga afro 16% e tyre që kanë njohuri mbi këto parime, por ende nuk kanë filluar t'i zbatojnë ato në kompanitë e tyre.


Grafiku 5.2. më poshtë tregon se 45% e respondentëve besojnë se shoqatat e biznesit duhet të ndërmarrin aktivitete të rritjes së ndërgjegjësimit mbi qeverisjen korporative, përcjellë nga rreth 35% e atyre që besojnë se institucionet financiare dhe/ose organizatat donatore kanë një rol për të luajtur në këtë drejtim, gjë që është rritur krahasuar me Studimin e vitit të kaluar, i cili gjeti 27% të atyre që besonin të njëjtën gjë. Dhe së fundi, gati 20% pretendojnë se nuk është prioritet i tyre, për momentin, të ndërmarrin një ndërgjegjësim të tillë.





**Fig. 5.2. Cila nga opsionet më lartë do të rriste vetëdijesimin rreth qeverisjes korporative?**

Në grafikun 5.3. më poshtë, mund të shohim se afërsisht 65% e respondentëve kanë një kod etik dhe e zbatojnë atë siç duhet, gjë që gjen një rritje të lehtë, krahasuar me studimin e vitit 2020, prej 61%. Për më tepër, ka një ndryshim në bizneset të cilat kanë kod etik por nuk kanë nisur ende ta zbatojnë atë, i cili ka rënë nga studimi i vitit të kaluar nga 8% në 6% këtë vit. Përqindja e atyre që kanë raportuar se nuk kanë kod etik është mjaft e ngjashme me atë të vitit të kaluar nga 11% në 12.4%, pasuar nga 16.5% e bizneseve që nuk kanë kod etik, por kanë në plan të krijojnë një të tillë.



**Fig. 5.3. A kanë bizneset kod etik?**

## 6. Konkluzionet

- Bizneset e perceptojnë se ka pasur një rënie të shkallës së korrupsionit, nga 58% në 2020 në 44% në 2021.
- Emigrimi i fuqisë punëtore dhe korrupsioni radhitën si dy faktorët kryesorë me të cilët përballet Kosova, përcjellë me sistemi jo të zhvilluar arsimor dhe sistemin gjyqësor joefikas. Shkalla e perceptimit të korrupsionit krahasuar me pesë vitet e fundit është rritur në pikëpamjen e afro 12% të respondentëve.
- Pandemia COVID-19 vlerësohet të mos ketë ndonjë ndikim të theksuar me 42.15% të respondentëve.
- Ryshfeti përsëri mbetet lloji më i zakonshëm i korrupsionit në Kosovë, me rreth 62% të respondentëve që mendojnë kështu, përcjellë nga keqpërdorimi i parasë publike me 58% dhe nepotizmi dhe klientelizmi me 52%.
- Faktori kyç që kontribuon në korrupsion është sundimi i dobët i ligjit me 83% të respondentëve që besojnë kështu.
- Mungesa e vullnetit politik për të luftuar korrupsionin ka pësuar rënie të veçantë, që vlen të theksohet, nga 80% në vitin e kaluar me 61% këtë vit.
- Rreth 29% e respondentëve perceptojnë mungesë besimi ndaj sistemit gjyqësor.
- 18% e respondentëve nuk besojnë se mekanizmat e zbatimit, pra, policia, prokuroria dhe gjykatat në Kosovë, janë efektive në luftën kundër korrupsionit.
- Mbi 88% e respondentëve tregojnë se nuk kanë raportuar kurrë raste korrupsioni tek autoritetet.
- Institucionet që perceptohen më të korruptuarat sipas respondentëve, janë Organi Shqyrtues i Prokurimit me 57%, përcjellë nga gjykatat me 50%, si dhe ndërmarrjet me pronësi publike me 49%.
- Afërsisht 25% e përgjigjeve nga bizneset në këtë pyetësorë perceptojnë se gjatë viteve të karrierës së tyre, bizneset kanë hasur në korrupsion, i cili është ulur krahasuar me vitin e kaluar (40%).
- Rreth 32% e kanë renditur Organin Shqyrtues të Prokurimit, Administratën Tatimore të Kosovës dhe Gjykatat si tre institucionet në të cilat kanë hasur në korrupsion, përcjellë nga Doganat (26%), Qeveria (23%) dhe ndërmarrjet me pronësi publike (21%).
- 67% e respondentëve besojnë se ka korrupsion në sektorin privat.
- Rreth 25% e respondentëve kanë hasur në korrupsion dhe 50.41% besojnë të mos kenë hasur asnjëherë në ndonjë formë korrupsioni në sektorin privat.
- Korrupsioni i perceptuar nga funksionet e biznesit: mbi 41% e respondentëve besojnë se korrupsioni është më i pranishëm në auditim dhe kontabilitet, 39% besojnë se korrupsioni ndodh në shitje, 38% besojnë se korrupsioni është i pranishëm edhe në shërbimet ligjore.
- Në vitin 2021, vetëm 12% e respondentëve kanë pohuar se kanë raportuar korrupsion.
- 65% e bizneseve janë të besimit se do të raportojnë të gjitha rastet e korrupsionit në të ardhmen. Duke shënuar një rënie nga viti i kaluar (75%).
- Përqindja e respondentëve që përfundimisht nuk do të raportojnë korrupsionin është ulur nga 4.5% në 1.65%.



